

Rregullat e përgjithshme

VB AB Incoming 04 b)

Rregullat në vijim sipas §§ 1 deri 11 , vlejné për Incoming Sigurimet e shëndetit në Udhëtim, nga Kompania e Sigurimeve SIGURIA, me seli në rr. Luan Haradinaj LI A. 10000 Prishtinë – Kosovë, në tekstin e mëtuftjshëm SIGURIA, SIGURIA e ka kontraktuar Elvia-n, Shoqëri Aksionare për Sigurimet e shëndetit në udhëtim, Ludmilla Str 26, 81543 München, Gjermani, në tekstin vijues shkurtimishte Elvia, që të bëjë rregullimin dhe trajtimin e dëmeve.

§ 1 Kush është i siguruar?

Personat e siguruar janë të gjithë personat emri i të cilëve është i shënuar në policen e sigurimit, dhe kjo pasi që të jetë paguar primi sigurues.

§ 2 Për cilat udhëtime vlenë sigurimi?

Mbrojtja siguruese vlenë për një udhëtim të përkohshëm në Gjermani, Zvicerr, si dhe në të gjitha shtetet antare të cilat janë të përfshira në zonën e Shengen-it (zona e vlefshme).

§ 3 Kur mund të bëhet një sigurim, kur fillon dhe kur përfundon një sigurim?

1. Mbrojtja siguruese hyn në fuqi, nëse shuma e premisë është paguar para fillimit të udhëtimit.
2. Mbrojtja e sigurimit fillon që nga dita e hyrjes, gjegjësisht kalimit të kufirit, në njëren nga vendet e përcaktuara më lartë, dhe përfundon në kohën e marrveshjes, ose më së voni atëher kur mbaron udhëtimi i të siguruarit.

§ 4 Kur duhet të paguhet primi?

Primi duhet të paguhet në po të njëjtën ditë kur edhe merret policia e sigurimit.

§ 5 Në cilat raste nuk trajtoheni nga mbrojtja e siguruese?

Dëmet të cilat nuk janë të siguruar:

1. Atëher kur bëhet një grevë, gjatë protestave të mbrendëshme, luftës, energjisë atomike, konfiskimeve dhe sulmeve tjera të nivelit të lartë.
2. Atëher kur personit i komunikohet kjo paraprakisht.
3. Gjatë pjesëmarrjes në një ekspeditë.

§ 6 Çka duhet të ndër marrë urgjentisht personi i siguruar, në rast se paraqitet dëmi (obligimet)?

Personi i siguruar është i detyruar që :

1. Mundësisht dëmi të jetë sa më i vogël dhe të menjanojë shpenzimet e panevojshme.
2. Që për dëmet e shkaktuara gjithësesi të informoj Elvia-n
3. Ditën kur ka udhëtuar ta dëshmojë në formen më të përshtatëshme (Kopjen e dokumentit të udhëtimit, pasaporten - Vizen, nese është e domosdoshme për udhëtim, biletat e udhëtimit, biletat e Aeroplanit dhe të tjera);

4. Që për arsyet dhe rrethanat e dëmit të informoj ELVIA-n, si dhe të jet në gjendje të ket informata të sakta. Si dëshmi për këtë personi i siguruar duhet të paraqesë faturat origjinale, gjegjësisht dëshmit të cilat janë dhënë nga ana e mjekëve, gjithashtu personi i siguruar është i obliguar që mjekve të ELVIA Asistance- Notrufzentrale (qendra emergjente) tu lejohet qasja në informacionet paraprake në atë mënyrë që të mundësoj ELVIA-s, të merret me shkaqet dhe lartësinë e e kërkesës dhe të trajtoj atë.

§ 7 Kur i paguan ELVIA dëmshpërblimet ?

Atëherë kur ELVIA ka vërtetuar obligimin e shërbimeve, arsyen dhe shumën, pagesen e dëmshpërblimit do ta bëjë brenda dy javësh.

§ 8 Si vepohet nese personi i siguruar, ka ankesa shtesë ndaj palës së tretë ?

1. Ankesat shtesë ndaj palës së tretë rregullohen në bazë të rregullativave ligjore dhe merren nga ELVIA deri në shumën e pagur, nëse nga personi i siguruar nuk vije me ndonjë prapavijë.
2. Personi i siguruar është i obliguar që në këtë aspekt të bëjë ankesa shtesë te ELVIA.
3. Obligimet e shërbimeve nga kontratat tjera siguruese i takojnë obligimeve hyrëse të ELVIA-s. Kjo vlenë posaqërisht për shërbimet ligjore të siguruesve nga sigurimi social.

Nëse personi i siguruar, paraqet fatura origjinale te Elvia dhe i merren parasysh atëher ato do të merren si shërbime paraprake.

§ 9 Kur e humb personi i siguruar të drejtën e ankesës për shërbimet e sigurimeve, nëse ai nuk respekton obligimet e tij?

1. Nese paraprakisht nuk respektohen obligimet, atëher ELVIA është e liruar nga obligimet e trajtimit të dëmit. Te cenimet e mëdha ELVIA është e autorizuar, që shërbimet në rastin më të rëndë të obligimeve te personi i siguruar , të zbresë shumën në bazë të raporteve obligative.
2. Personi i siguruar duhet të paraqes dëshmi nëse ai nuk ka mundur të ti përmbahet obligimeve. Vetëm në rast se ai është jo korrekt, atëherë ELVIA, për oblimiet e shërbimeve, duhet te pret nga personi i siguruar që të dëshmojë një gjë të tillë, dhe deri atëherë mos respektimi i obligimeve, si para hyrjes ashtu edhe para vendosjes për rrethanat e obligimeve të shërbimit janë arsye për ELVIA-n për vëllimin e trajtimit të obligimeve.
3. Kërkesa për shërbimet e Sigurimit mund të zgjatë deri në 3 vjetë, duke llogaritur nga fundi i vitit, gjegjësisht në atë vit kur është bërë kërkesa ku personi i siguruar ka bërë me dije kërkesën për dëmshpërblim apo pa ndonjë shkelje të vrazhdë të obligimev ku dhe do të duhej të informohej.

§ 10 Cila formë vlenë për dhënjen e deklaratave vullnetare ?

Shpalljet dhe deklaratat vullnetare të personit të siguruar dhe Siguruesit, mundën të bëhen në formë Teksti (si psh. me leter postale, Fax, E-mail)

§ 11 Cila gjykatë në Gjermani është kompetente për ankesa, lidhur me kontratat siguruese, dhe cilat të drejtat mund të aplikohen ?

Kompetent është gjykata në Mynih. Shqyrtimet bëhen në bazë të të drejtave Gjermane, nëse nuk parshihet me ndonjë ligj tjetër ndërkombëtar.

Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim

VB RK Incoming 04 b) SB

§ 1 Çka është e siguruar ?

1. Të siguruarat janë shpenzimet si :
 - a) Trajtimi mjekësor ;
 - b) Transportimi i pacientit;
 - c) Shpenzimet e varrosjes në rast vdekje, në një shumë të përgjithëshme deri në 30.000 Euro për çdo rast dëmi i cili shkaktohet gjatë udhëtimit të tij të përkohshëm në Gjermani, Zvicër, si dhe në të gjitha shtetet tjera në të cilat vlenë marrveshja e Shengenit, smundjet akute të paraqitura, dhe në rast të aksidenteve.

§ 2 Cilat shpenzime do të paguhen gjatë trajtimit mjekësor në kuadër të vlefshmërisë së sigurimit?

1. ELVIA zbaton premtimet në kuadër të vlefshmërisë së sigurimit për ndihmë mjekësore emergjente. Në këto obligime hyjnë shpenzimet si në vijim:
 - a) Trajtimin ambulantor nga ana e mjekut;
 - b) Trajtimi mjekësor përmes medikamenteve, që personi i siguruar është udhëzuar nga mjeku;
 - c) Trajtimi stacionar në spital duke përfshirë edhe operacionet e paparashikueshme ;
 - d) Transportin e domosdoshëm mjekësor deri te një trajtim stacionar në spitalin më të afërt të mundshëm në regjionin e vlefshëm dhe kthimi në vendbanim e tij;
 - e) Patericat e domosdoshme dhe qiraja për një karrocë invalidësh.
 - f) Dhëmbjet qetësuese dentale, dhe riparimi i protezave të dhëmbëve dhe atyre të përkohëshme deri në 125 Euro.
2. ELVIA mbulon shpenzimet e trajtimit stacionar deri në ditën e aftësisë transportuese, gjithsejtë më së gjati deri në 45 ditë, nga dita e fillimit të trajtimit, përderisa një transport kthyes deri në fund të udhëtimit nuk ka qenë i mundur për shkak të paaftësisë transportuese të personit të siguruar.
3. Për çdo trajtim që është i siguruar, personi i siguruar është i obliguar në vetëpjesëmarrje prej 100 Euro, përderisa një bartës tjetër i shpenzimeve nuk ka marr pjesë në këto shpenzime.

§ 3 Cilat shpenzimet mbulon ELVIA gjatë transportit kthyes dhe bartjes të siguruarit në rast vdekje ?

ELVIA mbulon :

1. Shpenzimet për përkujdesjen mjekësore kuptimplote, nga kontrata mjekësore e ELVIA Assistance – Notrufzentrale, transportin kthyes të personit të siguruar deri në vendlindje, gjegjësishtë deri tek spitali më i afërt në vendlindje, në një shumë të përgjithëshme prej 5000 Euro;
2. Shpenzimet e patjetersueshme për transportin e të siguruarit të vdekur deri në varrim, duke përfshirë edhe një arkivol të thjeshtë transportues, të cilat e kapin shumën prej 5000 Euro.

§ 4 Cilat janë kufizimet e mbrojtjes siguruese të cilat duhet respektuar ?

Mbrojtja siguruese nuk vlenë për :

1. Trajtimet mjekësore dhe masat tjera mjekësore të cilat janë shkaku i udhëtimit;
2. Trajtimet mjekësore dhe masat tjera mjekësore paraprake të cilat kanë qenë të njohura nga personi i siguruar para udhëtimit ose me pasojat e njohura paraprakisht i cili do të duhej të llogariste para udhëtimit;
3. Trajtimi i dhëmbëve të cilat e tejkalojnë trajtimet e pushimit të dhimbjeve, rregullimi i protezave të dhëmbëve të përhershme dhe të përkohshme, të cilat e tejkalojnë shumë mbi 125 Euro për çdo qëndrim;
4. Trajtimi me masazh dhe trajtimi Wellness si dhe rregullimi i protezave dhe paisjeve ndihmëse;
5. Eliminimi dhe trajtimi i dukurive të varshmërisë, si nga Alkoholi, Droga etj, për të cilat është i domosdoshëm kthimi transproues i pacientit.
6. Abortimet dhe lindjet si dhe pasojat e tyre që vije deri te transporti kthyes;
7. Nevojat për përkujdesje, kujdestaria ose trajtimet kushtezuese të të pamurit dhe strehimi duke përfshirë edhe transportin kthyes;
8. Trajtimi i sëmundjeve shpirtërore, si hipnosa, dhe Psikoterapia duke përfshirë edhe medikamentet përkatëse dhe transporti kthyes;
9. Dëmet e shkaktuara nga shkaku i pjesëmarrjes në demonstrata apo ndonje organizim sportiv, gjegjësishtë gjate ushtrimeve përkatëse duke përfshirë dhe transportin kthyes.

§ 5 Çka duhet patjetër të ndërmerri personi i siguruar në rast të trajtimit mjekësor (Obligativ)

Personi i siguruar është i detyruar që

1. Obligativisht në rast të trajtimit stacionar në spital dhe para diagnostifikimeve trajtuese gjithpërfshirëse dhe masave trajtuese terapeutike patjetër të kontaktoi ELVIA Assistance Notrufzentrale.

2. Transporti kthyes apo kthimi në vendlindje për të verifikuar aftësitë udhëtuese nga ELVIA Assistance Zentrale, për lejin e transportit kthyes me nevojshmërinë adekuatë trajtuese.

§ 6 Cilat rregulla shitesë për mbrojtje Siguruese që vlejné për KS SIGURIA sigurimet e shëndetit në udhëtim gjatë udhëtimit -qëndrimit të të siguarit në Gjermani ?

Mbrenda teritorit të Gjermanise, trajtimet do të realizohen në bazë të § 2 më së larti 1.8- ten nga tarifa, të rregullave tarifore për mjek, GOÄ ose rregullave tarifore për Dentist, GOZ, kryesisht shërbimet tekniko-mjekesore do të reaizohen maksimalisht deri në 1.3-ten e tarifës, shërbimet laboratorike maksimalisht deri në 1,15 –ten e tarifës. Te trajtimet stacionare sipas § 2 Nr.1 dhe 2 do të vendoset sipas rregullave të paracaktuara dhe kushteve të përgjithshme të pagesave për trajtim vendor .

Sigurimi emergjent në udhëtim

VB RN Incoming 04 b)

§ 1 Cilat shërbime i ofron ELVIA ?

1. ELVIA i ofron personit të siguar gjatë udhëtimit të tij në rast emergjente ndihmë dhe përkrahje, dhe merr persiper shpenzimet të cilat ndodhin në kornizat e lartshënuara. E drejta për vërtetim provash i takon ELVIA –s. Shërbimet e ofruara dhe deklaratat për marrje përsiper të shpenzimeve, nga ELVIA Assistance Notrufzentrale, si dhe kontraktimi për bartësit e shërbimeve nuk përmbajnë detyrimet e obligimeve hyrëse nga ELVIA, që vije nga kontrata siguruese ndaj personit të siguar.
2. ELVIA kontraktton Assistance Notrufzentrale, për personat e siguar tek ELVIA, dhe atyre u ofron ndihmë shërbimi 24 Orë pandërprerje kohore.
3. Personi i siguar ka të drejtë kërkesë për shërbimet emergjente në raste aksidentale dhe është i obliguar që paraprakisht të kontaktoi me ELVIA Assistance Notrufzentrale.
4. Përderisa personi i siguar ose nga ELVIA apo ndonjë bartes tjetër i shpenzimeve, për llogaritë e paraqitura bënë kërkesë, atëher personi i siguar brenda një muaji pas paraqitjes së faturave do të pranoj pagesat nga ELVIA.

§ 2 Cilat Shërbime ndihmëse i ofron ELVIA Assistance Notrufzentrale tek smundjet apo fateqeqësitë ?

1. Trajtim stacionar, deklara për marrje përsiper të shpenzimeve, te trajtimi stacionar spitalor, ELVIA do ti jep spitalit deklaratën për marrje përsiper të shpenzimeve, deri në 13.000 Euro. Kjo deklaratë nuk përmbanë njohje të shërbimeve obligative. ELVIA në emër të personit të siguar i merr përsiper faturat si bartës kompetent i shpenzimeve.
2. Transporti kthyes i të siguarit .
Përderisa kontrata e mjekëve nga ELVIA Assistance Notrufzentrale e cila bëhet me marreveshje me mjeket vendor dhe e shohin si kuptimplote, atëher ELVIA Assistance Notrufzentrale organizon transportin kthyes, me të gjitha mjetet transportuese adekuatë mjeksore (duke përfshir edhe aeroplanin ambulator), deri tek spiatli gjegjëse më i afërt në vendlindje të personit të siguar.

§ 3 Cilat Shërbime ndihmëse i ofron ELVIA Assistance Notrufzentrale nëse personi i siguar vdes ?

Nëse personi i siguar gjatë udhëtimit të tij vdes, atëher ELVIA Assistance Notrufzentrale , sipas dëshirës së familjarve mund ta varros atë jashtë vendlindjes, ose mund ta transportoj personin e vdekur deri te vendvarrimi në vendlindje.